

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE TREGËTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
" REINA" SH.P.K

Në Berat më datë **07.07.2023**. si më poshtë,

Z. Alket Ngjeqari , atësia Rahmi lindur me Berat dhe banues në Tirane, madhor, me zotesi të plote juridike dhe për të vepruar, i identifikuar nga Karta e Identitetit me nr. I10614091H me cilësinë e ortakut të Vetëm të shoqërisë dhe me vullnetin e tij të lirë e të plotë vendosi të krijojë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin

" REINA" SH.P.K

me adrese Berat, Zona Kadastrale nr.8501, Nr. Pasurie 13/76-G5, Volumi 19, faqe 136.

Neni 1

EMËRTIMI DHE QENDRA E SHOQËRISË

EMËRTIMI: " REINA" SH.P.K

SELIA: Berat, Zona Kadastrale nr.8501, Nr. Pasurie 13/76-G5, Volumi 19, faqe 136.

Shoqëria do të jetë person juridik me regjistrimin në QKB sipas nenit 22 të Ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” e në bazë të Ligjit Nr.9901 të datës 14.04.2008 “PËR TREGËTARËT DHE SHOQËRITË TREGËTARE”. Shoqëria do të gëzojë të gjithë të drejtat si person juridik dhe do të fillojë veprimtarinë e saj nga data e regjistrimit në Q.K.B.

Neni 2

QËLLIMI I SHOQËRISË

Objekti i i veprimtarise se Shoqërisë do të jetë:

Investimi ne instrumenta financiar (te cilet perfshijne pa kufizime titujt e pjesemarrjes ne kapitalin e shoqerive tregtare, titujt e borxhit, aksionet ose kuotat ne fonde investimesh etj), investimi ne pasuri te paluajtshme dhe ne asete (te prekshme apo te paprekshme), si dhe ofrimi i sherbimeve te konsulences per shoqerite e kontrolluara prej saj dhe/ose te trete (te cilet perfshijne pa kufizime konsulencen e natyres financiare, manaxheriale, ligjore, IT, zhvillim softwares etj.) ne perputhje me legjislacionin e zbatueshem ne territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj, Gjithashtu, shoqeria mund te kryejë cdo veprim, operacion apo transakcion tjeter komercial, industrial e financiar, te dobishem apo plotesues ndaj permbushjes se objektit te shoqerise, me kusht qe aktivitetet e mesiperme te mos jene ne kundërshtim dhe mos alterojne objektin paresor te veprimtarise se shoqerise.

Neni 3

REGJISTRIMI JURIDIK I SHOQËRISË

“Shoqëria”, në veprimtarinë e saj bazohet në legjislacionin e Republikës se Shqipërisë. Kjo shoqëri tregëtare krijohet me objektivin për të vazhduar veprimtarinë për një periudhë kohore pa afat.

Me vendim të “Ortakëve”, mund të ndryshojë regjimi juridik të Shoqërisë, në qoftë se në të ardhmen krijohen përmasa më të favorshme për funksionimin e saj sipas Legjislacionit Shqipëtar. Në këtë rast “Ortakët” do të përshtasin “Kontratën e Themelimit”, dhe “Statutin e Shoqërisë”, si dhe regjistrimin e tyre nga organet kompetente Shqipëtare.

“Shoqëria” gëzon personalitet juridik nga dita e miratimit dhe e regjistrimit të tregëtar në Q.K.B.

“Shoqëria” mund të ketë pasuri të luajtëshme dhe të paluajtëshme në përputhje me dispozitat e Legjislacionit Shqipëtar.

Pasuria mbrohet sipas dispozitave të ligjit në fuqi.

“Shoqëria” *do të ketë vulën e saj të cilën do ta caktojë me Vendimin e Ortakeve të shoqërisë.*

Neni 4

KAPITALI-THEMELTAR

Për te siguruar funksionimin fillestar të Shoqërisë, “Ortakët e shoqërisë” formojnë kapitalin fillestar të shoqërisë prej 120,000 Euro (12,549,600 lekë) kursi i kembimit 1 Eur=104.58 All.

Ortaku i Vetëm Z.Alket Ngjeqari është zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 120,000 Euro (12,549,600 lekë) që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose natyrë (pasuri të luajtshme/ të paluajtshme, apo të drejta).

Nga momenti i vendosjes së kontributit të kapitalit themeltar të Shoqërisë, Shoqëria fiton të drejtën e pasjes, përdorimit dhe disponimit të këtij elementi pasuror, në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë dhe urdherimet e këtij **Akt Themelimi dhe Statutit të Shoqërisë.**

Shtesa e kapitalit themeltar, vendoset me vullnetin e ortakëve. Kapitali themeltar mund të shtohet në varësi të aktivitetit, nga kontributet plotësuese të ortakëve

Shtesa e kapitalit themeltar, vendoset me vendim të Ortakeve të shoqërisë.

Kapitali i shoqërisë kontribuar nga çdo ortak do të regjistrohet në librin e regjistrimit të kapitalit të shoqërisë.

Neni 5

DREJTIMI I SHOQËRISË

Në kuptim të këtij Akti-themelues , **Ortaku i Vetëm i shoqërisë është:**

Z.Alket Ngjeqari.

Detyrën e administratorit do ta kryejë, **Z. Alket Ngjeqari**.për një **afat kohor 5-vjeçar**, nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKB.

Mënyra e emërimit dhe kopetencat e tij përcaktohen nga statuti i shoqërisë në përputhje me Legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 6

ADMINISTRATORI

Ortakët e shoqërisë vendosin që administratori i Shoqërisë : **“REINA” SH.P.K** të jetë **Z.Alket Ngjeqari**. Administratori mund të kryejë të gjitha veprimet ligjore që janë në interes të shoqërisë në përputhje me Statutin e Aktin e Themelimit të saj.

Administratori do të ketë autoritet të përgjithshëm në aktivitetin e zakonshëm dhe jashtzakonshëm të shoqërisë dhe ka të drejtën e marrjes së çdo ndermarrje dhe çdo veprimi që konsiderohet i nevojshëm për realizimin e qëllimit të shoqërisë me përjashtim të rasteve që ligji “Mbi Tregtarët dhe Shoqëritë Tregëtare” i kufizon. Administratori ka të drejtë t’i propozojë mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve planin e mbledhjeve duke marrë vendime për zhvillimin e veprimtarive të shoqërisë, duke përcaktuar dhe linjat kryesore të veprimtarisë së shoqërisë.

Administratori ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhënie me të tretët për përmbushje të aktivitetit të saj në përputhje me parashikimet në statutin e kësaj shoqërie.

Organi Administrativ (administratori) është kopentet për të:

realizuar mbledhjen e Asamblesë duke njoftuar ortakët me shkrim 15 ditë më parë:

- miratuar planet dhe bilancet periodike mujore dhe tre mujore;
- propozuar strukturën e aparatit të shoqërisë;
- të marrë në punë person atë ndryshëm dhe rregullimin e marrëdhënieve të punës me ta:

- propozuar rregullimin, krijimin dhe destinimin e fondeve të ndryshme (të veçanta), ndarjen e fitimit etj.:
- përfaqësuar apo emëruar përfaqësues në çeshtje gjyqësore që mund të ketë shoqëria:
- emëruar përfaqësues duke I deleguar të gjitha ose ose një pjesë të kopetencave të tij.

Neni 7

SIGURIMI I SHOQËRISË

Pasuria e Shoqërisë sigurohet në bazë të Legjislacionit te Republikës së Shqipërisë.

Neni 8

BILANCI, VEPRIMTARIA EKONOMIKE, DETYRIMET

Shoqëria mban përgjegjësi për të gjitha detyrimet shtetërore, sigurimet shoqërore, etj. Ortakët themelues ose persona të tjerë të autorizuar prej tij kanë të drejtë që me nxjerrjen e bilanceve ekonomike, çdo fund-viti kalendarik, të përfitojnë përqindjet e realizuara nga veprimtaria private.

Shoqëria "REINA" SH.P.K ushtron aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës se Shqipërisë.-

Të gjitha mosmarrveshjet me person afizik ose juridik, vendas ose të huaj si dhe organet shtetërore, zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 9

KOHËZGJATJA E VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Afati i veprimtarisë të kësaj Shoqërie është *pa afat të caktuar*, por aktiviteti fillon nga data e nënshkrimit të këtij akti. Afati i funksionimit të Shoqërisë është afati i veprimit te Akt-Themelimit, që fillon nga data e regjistrimit në QKB.

Neni 10

LIKUJDIMI I SHOQËRISË

Raste dhe proceduara e likujdimit të Shoqërisë, si dhe mbarimi i Afatit të Aktit të Themelimit të shoqërisë përcaktohen ne **Statutin** e saj.

Neni 11

DISPOZITA TË PËRGJITHËSHME

Ndryshime të favorshme ne Legjislacionin Shqipëtar

Ky Akt-Themelimi I Shoqërisë ka si aneks Statutin e Shoqërisë.Çdo ndryshim dhe shtesë e këtij Akt-Themelimi, si dhe Statutit, bëhet me Vendim të Ortakeve te shoqerise. Në qoftë se në Republikën e Shqipërisë shpallen ligje, dekrete, ose vendoset nje politikë më e favorshme nga Legjislacioni ekzistues gjatë kohës së vendosjes së shoqërisë, atehere “Ortaket”, kane të drejtë ti drejtohet organeve përkatëse shtetërore që të zbatojnë legjislacionin më të favorshëm.

Çështjet e pa mbuluara nga ky statut do të rregullohen nga legjislacioni Shqiptar dhe në veçanti nga **Ligji Nr.9901 dt. 14.04.2008** “Mbi Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare”.

Ky Akt-Themelimi nënshkruhet ne Tiranë, dhe hartohet në katër kopje ne gjuhën shqipe.-

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË

Alket Ngjeqari